



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 295/3 Prot.

Tiranë, më 22 / 01 /2026

Drejtuar: Komisionit përgjegjës për punët e jashtme

Drejtuar: Kuvendit të Shqipërisë

Baza Ligjore: Neni 71 i Rregullores së Kuvendit

Neni 75 i Rregullores së Kuvendit

Objekti: *Amendament në projektligjin “Për ratifikimin e Marrëveshjes së pranimi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryeministri Edi Rama, në Kartën e Bordit të Paqes”*

Të nderuar anëtarë të Komisionit,

Të nderuar deputetë,

Me qëllim garantimin e kushtetutshmërisë në projektligjit “Për ratifikimin e Marrëveshjes së pranimi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryeministri Edi Rama, në Kartën e Bordit të Paqes”, vlerësojmë se është e domosdoshme disa ndryhime në përmbajtjen e tij, në përputhje me nenin 121 të Kushtetutës dhe ligjin nr. 43/2016.

Republika e Shqipërisë në organizata ndërkombëtare përfaqësohet nga institucione, dhe jo nga individë. Për këtë qëllim, referimi duhet të bëhet tek institucioni dhe jo tek individët. Është e paprecedent në historinë e Shqipërisë dhe të të drejtës

ndërkombëtare, aderimi apo pranimi i një marrëveshje ndërkombëtare nuk ndodh kurrë që të bëhet me emra konkret.

Për të gjitha argumentet si më sipër, në mbështetje të nenit 71 dhe 75 të Rregullores, propozoj, amendamentet si më poshtë:

Amendament 1:

Titulli të riformulohet:

“Për ratifikimin e marrëveshjes së pranimi të Republikës së Shqipërisë, në Kartën e Bordit të Paqes”.

Amendament 2:

Neni 1 ndryshohet si vijon:

“Ratifikimin e marrëveshjes së pranimi të Republikës së Shqipërisë, në Kartën e Bordit të Paqes, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij”.

Amendament 3:

Pas nenit 1, shtohet neni 2, me këtë përmbajtje:

“Në përputhje me nenin 2.2, shkronja “a” e Kartës së Bordit të Paqes, Republika e Shqipërisë do të përfaqësohet në Bordin e Paqes nga Presidenti i Republikës ose me autorizim të tij nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kompetencat që i njeh Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.”.

Sa më sipër, në përputhje me nenin 71 dhe 75 të Rregullores së Kuvendit, propozoj shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimeve sa më sipër.

DEPUTETI:

GAZMENT BARDHI